VENDIM
Nr.45, datë 7.6.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ELEKTRO LUBONJA" SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa "a", nenit 9 dhe 13 pika 1, germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1 germa "a" të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, bordi i komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.06.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Elektro Lubonja" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikën 4.1.5 germat "a" dhe "c" të nenit 9, përkatësisht: Miratimi i OST-së dhe OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të tregtimit dhe leja mjedisore nga organet përkatëse është në pritje për t'u plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Elektro Lubonja" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga "Hec - Lubonjë".

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta